



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.879/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Hasim Rudi nga Subjekti Politik Partia Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet pjesërisht** i bazuar apeli Anr.879/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Hasim Rudi nga Subjekti Politik Partia Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Malishevës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, në Qendrat e Votimit: QV 3016A dhe QV 3052A.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. Refuzohet e pabazuar** pjesa e apelit e paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Hasim Rudi nga Subjekti Politik Partia Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në Qendrën e Votimit: QV 3019A.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Hasim Rudi nga Subjekti Politik Partia Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Malishevës, në të cilën pretendon se në qendrat e votimit 3052A, 3016A dhe 3019A ka vërejtur dhe disa votues e kanë kontaktuar se në disa qendra të votimit nuk i kanë dalur as në formularin përfundimtar dhe kanë deklaruar se e kanë votuar të njëjtin.

Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e 9 dëshmitarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Hasim Rudi nga Subjekti Politik Partia Nisma Socialdemokrate me seli në Prishtinë ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në qendrat e votimit 3052A, 3016A dhe 3019A në Malishevë.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për kuvend komunal Hasim Rudi ka vetëm 6 vota, ndërsa sipas deklaratave të votueseve të bashkangjitura në apel e që ndërliken me këto QV, deklarojnë se kanë votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratatë të votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatojë se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklarata e dorëzuar për QV-në e vendosura në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmi se ka pasur vota në atë QV, poashtu për paneli është e qartë se në këto QV kandidati në fjalë ka pasur vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shpresore ankuesi në QV e vendosur në pikën IV të dispozitivit nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa

janë publikuar në rezultatin përfundimtar, prandaj u vendos si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.879/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferr



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.